



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 3: Statistikat Ekonomike**

# **Konsumi i Energjisë në Ekonomitë Familjare 2015**







Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 3: Statistikat Ekonomike**

# **Konsumi i Energjisë në Ekonomitë Familjare 2015**



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS  
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA  
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)  
Data e botimit: Prill, 2018  
© : *Agjencia e Statistikave të Kosovës*  
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.  
Informata të shumta janë në dispozicion në internet,  
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së  
në internet: <http://ask.rks-gov.net>

## Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për herë të parë ka përgatitur hulumtimin me të dhëna për konsumin e energjisë në ekonomitë familjare. Ky publikim (hulumtim) statistikor paraqet të dhëna statistikore për vitin 2015 mbi konsumin e energjisë.

Për mbledhjen e të dhënave është përgatitur një pyetësor nga ASK-ja sipas kërkesave të Eurostatit, me tendencë të modifikimit në të ardhmen.

Ky publikim do të përsëritet tre apo katër vite nga ASK-ja.

Duke u bazuar në kërkesa të vazhdueshme nga shfrytëzues të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm dhe në bazë të indikatorëve që publikon EUROSTAT-i për statistika energjetike, kemi prezantuar të dhëna me interes.

Qëllimi i publikimit është që të vejë në dukje tendencën e zhvillimit të këtij sektori.

Publikimi do të shërbejë si bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore të ASK-së dhe do të shërbejë si informacion i dobishëm dhe relevant ekonomik për Kosovën.

### Publikimin e përgatitën:

Ilir T.Berisha – Drejtor i Departamentit  
Ismail Sahiti – Shef i Divizionit të Statistikave Ekonomike  
Hysni Elshani – Shef i sektorit të statistikave Ekonomike  
Bekim Bojku – Zyrtar  
Qendresa Shala – Zyrtare  
Violeta Syla – Zyrtare  
Sulltane Gashi – Zyrtare  
Dafina Kumnova – Zyrtare  
Bekim Canolli – Zyrtar  
Ahmet Cakolli – Zyrtar për dizajnim.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund t'i dërgoni në adresën elektronike:  
(E-mail: [economic@rks-gov.net](mailto:economic@rks-gov.net))

Prill, 2018

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së,  
z. Isa Krasniqi

## **Simbolet dhe shkurtesat**

**GWh** – Njësia matëse për energjinë elektrike (Giga wat orë energji).

**MWh** – Njësia matëse për energjinë elektrike (Mega wat orë energji) ( 1GWh=1000MWh).

**TJ** – Njësia matëse për nxehtësinë (Tera Joule)

**KEEF** – Konsumi i energjisë në ekonomitë familjare

**QR** - Qarku regjistruar

**PPM** – Probabiliteti Proporcional i madhësisë

**GLN** - Gaz i lëngshëm i naftës

## **Çelësi i simboleve**

- Nuk aplikohet

: Nuk ka të dhëna.

## Përmbajtja

	Faqe
1 Definicionet Popullata dhe Metodologjia.....	4
1.1. Definicionet.....	4
1.2. Popullata.....	4
1.3. Mostra.....	4
1.4. Llogaritja e vlerësimeve.....	8
2 Njësitë e banimit (banesat, shtëpitë).....	9
3 Ekonomitë familjare.....	10
4 Përdorimi i energjisë.....	12
4.1. Përdorimi i energjisë nga ekonomitë familjare.....	12
4.2. Ngrohja e hapësirës.....	14
5 Pajisjet elektrike në amvisëri.....	15

## 1 Definicionet Popullata dhe Metodologjia

### 1.1. Definicionet<sup>1</sup>

Ekonomia familjare përfshinë të gjithë personat që jetojnë në një banesë të përbashkët dhe që kanë të përbashkëta mjetet kryesore të jetesës. Ekonomia familjare këtu i referohet konceptit të ekonomisë familjare private, për dallim nga ekonomitë kolektive siç janë grupet fetare, qendrat shëndetësore, jetimore, etj.

Ndërtesa - Çdo strukturë e pavarur e cila përmban një ose më shumë banesa, dhoma ose hapësira të tjera, të mbuluara me një kulm dhe të rrethuara me mure të jashtme ose mure ndarëse që shtrihen nga themeli deri në kulm, qoftë ajo e dizajnuar për banim apo për qëllime bujqësore, komerciale, industriale ose kulturore apo për ofrimin e shërbimeve.

Njësi e banimit, e quajtur edhe banesë - Banesë konvencionale apo vend jo konvencional i banimit të zakonshëm ku njerëzit janë duke jetuar në kohën e regjistrimit të popullsisë.

Urbane- Një zonë e urbanizuar gjeografike - e definuar në nivelin të vendbanimit- karakterizohet me densitet më të madh të popullsisë dhe tipare të mëdha njerëzore krahasuar me zonat përreth. Në regjistrimin e popullsisë në Kosovë një zone është përkufizuar si urbane me vendim administrativ të komunës.

Rurale- Zonë gjeografike jo e urbanizuar - e përkufizuar në nivel vendbanimi - që karakterizohet me densitet më të ulët të popullsisë dhe zakonisht shumica e tokës shfrytëzohet për bujqësi krahasuar me zonat përreth. Në regjistrimin e popullsisë në Kosovë një zonë është përkufizuar si rurale me vendim administrativ të komunës

### 1.2. Popullata

Popullata e Anketës së Konsumit të Energjisë në Ekonomitë Familjare përbëhet nga banesat (shtëpitë) në Kosovë. Si kornizë për nxjerrjen e mostrës së KEEF janë përdorur të dhënat nga Regjistrimi i Popullsisë së Kosovës i vitit 2011 të rifreskuara gjatë viteve 2013 dhe 2014. Korniza e mostrës përmbante 4626 qarqe. Korniza e mostrës e QR-ve fillimisht është ndarë në shtresa/strata bazuar në viset urbane dhe rurale në çdo rajon.

### 1.3. Mostra

Konsumi i energjisë në ekonomitë familjare (KEEF) është një studim i bazuar në një mostër probabiliteti, pra karakteristikat e popullsisë vlerësohen duke përdorur të dhënat e mbledhura nga njësitë e mostrës dhe duke aplikuar teorinë e probabilitetit.

Mostra është përzgjedhur me probabilitet proporcionalë me madhësinë (PPM) në secilën shtresë/stratë, ku madhësia bazohej në numrin e ekonomive familjare në qarkun regjistruar (QR) nga korniza e Regjistrimit të Popullsisë.

Për të siguruar një shpërndarje gjeografikisht të barabartë të mostrës, të dhënat në shtresa janë renditur sipas kodit të regjionit, kodit të komunës dhe kodit të qarkut.

---

<sup>1</sup> Janë marr tek manuali i regjistrimit të popullsisë



Për mostrën e energjisë, në fazën e parë janë përzgjedhur gjithsej 500 QR mostër, të ndara në shtresa/strata përafërsisht proporcionalisht me numrin e ekonomive familjare. Në fazën e dytë janë përzgjedhur 10 ekonomi familjare brenda secilit QR ( $500 \cdot 10 = 5000$ ). Në anketë janë përgjigjur 4,284 Ekonomi familjare, Tabela 1 paraqet popullsinë dhe madhësitë e mostrës, si dhe probabilitetin e përfshirjes në regjione.

Tabela 1. Popullata, madhësia e mostrës dhe probabiliteti i përfshirjes së Ekonomisë familjare

Regjioni	Ekonomitë Familjare	Mostra	Probabiliteti
1 Prishtina	103.077	1.340	0,013
2 Mitrovica	38.235	650	0,017
3 Peja	33.103	480	0,015
4 Prizreni	57.407	930	0,016
5 Ferizai	33.544	530	0,016
6 Gjilani	36.429	510	0,014
7 Gjakova	33.533	560	0,017
Totali	335.329	5.000	

Mbledhja e të dhënave është bërë përmes intervistave ballë për ballë gjatë së cilës u plotësua pyetësori i letrës.

Intervista u krye me një anëtar të familjes që u përgjigj në emër të të gjithë ekonomisë familjare. Zakonisht ishte një anëtar përgjegjës për ekonominë familjare.

Në rast kur ka pasur disa ekonomi familjare që jetojnë në të njëjtën njësi banimi, konsiderohej si një ekonomi familjare në qoftë se nuk kishte llogaritje të veçantë të shpenzimeve të ngrohjes.

Jo të gjitha njësitë e mostrës morën pjesë në studim. Kishte arsye të ndryshme për mos pjesëmarrje.

Në anketë e KEEF-t, mos përgjigjet kanë ndodhur për shkak se familja nuk mund të kontaktohej, familja nuk pranoi të merrte pjesë, familja nuk ishte në gjendje të merrte pjesë për shkak të sëmundjes ose ndonjë arsye tjetër, etj.

Tabela 2. Shkalla e përgjigjeve sipas Regjioneve

Regjioni	Madhësia e mostrës Numer	Përgjigjet	
		Numër	Në %
1 Prishtina	1.340	1.041	77,69
2 Mitrovica	650	491	75,54
3 Peja	480	361	75,21
4 Prizreni	930	906	97,42
5 Ferizai	530	514	96,98
6 Gjilani	510	495	97,06
7 Gjakova	560	476	85,00
<b>Totali</b>	<b>5.000</b>	<b>4.284</b>	<b>85,68</b>

Tabela 3 tregon se mbi gjysma e mos-përgjigjeve ishte për shkak të pamundësisë për të krijuar kontakte me ekonomitë familjare. Kjo ishte kryesisht për shkak se i pa anketuari nuk ishte në shtëpi, ku 47.77% ishin në këtë kategori (342 raste). Ndërsa refuzimet, grupi më i madh ishte refuzimi kategorik dhe refuzimi pa justifikim. Kjo ndodhi në 254 raste, apo 35.47%, arsyet tjera ishin 16.76%.

Tabela 3. Numri i të pa anketuarve dhe shkaku i mos përgjigjeve

Arsyet per mos pergjigje	Totali	%
<b>Te pa kontaktuara</b>	<b>342</b>	<b>47,77</b>
Ekonomia familjare në mostër jeton jashte vendit	85	11,87
Ekonomia familjare në mostrë nuk banonte në vendin e saj të qëndrimit gjatë periudhës së anketimit	73	10,20
Intervistuesi nuk ishte në gjendje për të gjetur personin që do të intervistohet për shkak se ai / ajo nuk ishte në shtëpi	50	6,98
Intervistuesi nuk ishte gjendje të hyjë në shtëpinë	13	1,82
Arsyeja tjetër kur Ekonomia familjare për t'u intervistuar nuk mund të gjendet	121	16,90
<b>Refuzim</b>	<b>254</b>	<b>35,47</b>
Refuzimi (kategorik) për t'u përgjigjur	87	12,15
Refuzimi për shkak të mungesës së kohës	28	3,91
Refuzimi për shkak të gjendjes së dobët ekonomike	34	4,75
Mungesa e besimit, dyshimi në lidhje me aftësinë për të siguruar fshehtësinë e të dhënave	103	14,39
I anketuari ka marrë pjesë tashmë në anketa	2	0,28
<b>Arsye të tjera</b>	<b>120</b>	<b>16,76</b>
Nuk i përgjigjej për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme në familje	73	10,20
Probleme shëndetësore, invaliditeti, aftësi të kufizuara, etj.	10	1,40
I moshuar, dhe për këtë arsye nuk mund të marrin pjesë në sondazh	8	1,12
I anketuari nuk ka qenë në vendin e caktuar, në kohën e rënë dakord ose kontakti është shmangur	4	0,56
Tjetër	25	3,49
<b>Totali</b>	<b>716</b>	<b>100</b>

#### 1.4. Llogaritja e vlerësimeve

Në studimin e mostrës vërehet vetëm një pjesë e popullsisë. Rezultatet e anketimit janë zgjeruar në të gjithë popullsinë duke llogaritur peshat për çdo ekonomi familjare të përgjigjur.

Llogaritja e peshave përbëhet nga fazat e mëposhtme:

- ✓ llogaritja e peshave bazë;
- ✓ rregullimi i peshave për mos përgjigje;
- ✓ rregullimi;

**Peshat e projektimit** : Peshat e dizajnit është e kundërta e probabilitetit të përfshirjes (shih Tabelën 1). Mundësitë e përfshirjes mund të llogariten pas përzgjedhjes së mostrës për të gjitha njësitë e mostrës. Për njësinë  $i$  në shtresën  $h$ , probabiliteti i përzgjedhjes në mostër, pra probabiliteti i përfshirjes është :

$$\pi_{hi} = \frac{n_h}{N_h},$$

ku  $N_h$  është numri i përgjithshëm i Ekonomive familjare në kornizën e marrjes së mostrave në shtresën  $h$  dhe  $n_h$  është madhësia e mostrës në shtresën  $h$ .

Peshat e projektimit është llogaritur për të gjitha ekonomi familjaret e përzgjedhura: ekonomi familjaret e intervistuar dhe jo të intervistuar.

Një sasi e caktuar e mos përgjigjeve është tipike në sondazhet e mostrës. Ashtu si me çdo gabim, ato mund të ndikojnë në vlerësimet përfundimtare duke rezultuar në vlerësime të njëanshme. Prandaj, duhet të ekzistojnë procedurat për të matur efektin e gabimeve dhe për të zvogëluar paragjykimin. Këtu është përdorur korrigjimi i peshës për t'u përshtatur për paragjykimin pa përgjigje. Kjo është bërë në dy hapa.

Së pari, probabiliteti i përgjigjes së ekonomi familjares u vlerësua duke aplikuar modelin e regresionit logjik me variablat e pavarura të tipit të qarkut dhe të zonës së urbanizuar. Së dyti, rregullimi i peshës për mos përgjigjet është llogaritur duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$w_{hi}^* = w_{hi} / r_{hi}.$$

Për llogaritjet përfundimtare u llogaritën duke përdorur peshat e rregulluara në të dhëna të njohura në bazë të projeksioneve të popullsisë dhe nga burime të tjera në mënyrë që të zvogëlohej paragjykimin i shkaktuar nga gabimet mos përgjigjeve në kornizë.

## 2 Njësitë e banimit (banesat, shtëpitë)

Numri i përgjithshëm i banesave ishte 366 020, ku 333 290 ishin të banueshme nga të cilat 64.88% ishin në zonat rurale dhe 35.12% në zonat urbane.

Tabela 4. Njësitë e banimit sipas zonave

Hapësirat e banueshem sipas zonave	Gjithsej	Perqindje
Urbane	117.051	35,12 %
Rurale	216.239	64,88 %
Totali	333.290	100,00 %

Sa i përket llojeve të banesave, në zonat urbane dhe rurale tabela 5 paraqet konfiguracionin e tyre:

Tabela 5. Konfiguracioni i hapësirave të banimit nëpër zona

Hapësirat e banuara sipas tipit të ndërtimit	Rurale	Urbane	Totali
Banes	2.279	22.012	24.291
Shtëpi	193.769	115.229	308.998
Totali	196.048	137.241	333.289

### 3 Ekonomitë familjare

Ekonomia familjare përfshinë të gjithë personat që jetojnë në një banesë të përbashkët dhe që kanë të përbashkëta mjetet kryesore të jetesës. Ekonomia familjare këtu i referohet konceptit të ekonomisë familjare private, për dallim nga ekonomitë kolektive siç janë grupet fetare, qendrat shëndetësore, jetimoret, etj. Ekonomi familjaret mund të përbëhen vetëm nga një anëtar.

Tabela 6. Madhësia e ekonomive familjare sipas zonave

Numri i anëtarve	Urbane	Rurale	Totali
1	2.279	4.166	6.445
2	9.546	10.615	20.161
3	16.950	12.873	29.823
4	54.142	58.280	112.422
5	268.824	310.998	579.822
6 dhe më shumë	325.929	703.391	1.029.320
<b>Totali</b>	<b>677.670</b>	<b>1.100.323</b>	<b>1.777.993</b>

Në vitin 2015, numri i përgjithshëm i hapësirave për banim ishte 366 020, kurse i Ekonomive familjare ishte më i vogël (333 290).

Tabela 7. Ekonomitë familjare dhe madhësitë e tyre

Numri i anëtarve	Banesa	Shtëpi	Totali
0	1.683	31.048	32.731
1	1.374	7.138	8.512
2	2.146	16.256	18.401
3	3.938	23.745	27.683
4	5.148	43.058	48.206
5	4.344	63.030	67.375
6 e më shumë	7.341	155.772	163.113
<b>Totali</b>	<b>25.974</b>	<b>340.046</b>	<b>366.020</b>

Tabela 8. Numri i ekonomive familjare sipas hapësirës ngrohëse

Hapësirat ngrohëse, m <sup>2</sup>	Në zonat Urbane	Në zonat Rurale	Total
Deri në 20	25.274	43.541	68.815
21-49	46.812	82.868	129.680
50-100	36.426	54.574	91.000
101-150	9.503	14.190	23.693
151 e më shumë	7.906	12.194	20.101
<b>Totali</b>	<b>125.923</b>	<b>207.366</b>	<b>333.289</b>

Në Kosovë mesatarisht ngrohën 51.58 m<sup>2</sup> (metra katro) për ekonomi familjare.

Tabela 8a. Hapësirat e ngrohura sipas kategorive

Hapësirat ngrohëse, m <sup>2</sup>	Ne zonat urbane	Ne Zonat Rurale	Total
Deri në 20	396.898	619.327	1.016.225
21-49	1.881.503	2.881.377	4.762.880
50-100	2.062.117	2.693.688	4.755.805
101-150	1.214.869	1.639.879	2.854.749
151 e më shumë	1.531.544	2.269.662	3.801.206
<b>Totali</b>	<b>7.086.931</b>	<b>10.103.934</b>	<b>17.190.865</b>

## 4 Përdorimi i energjisë

### 4.1. Përdorimi i energjisë nga ekonomitë familjare

Llojet e energjisë të përdorura nga ekonomitë familjare janë paraqitur në Tabelën 9. Analiza e energjisë dhe lëndëve djegëse të konsumuara (sipas numrit të amvisërive) treguan se energjia elektrike është përdorur në 99.8% të ekonomive familjare, 3.92% nga ngrohja e blerë nga sistemet e ngrohjes qendrore. Sa i përket lëndëve djegëse, dru zjarri ishte më i përdorur gjerësisht - me një mesatare të përdorur në 93.17% të ekonomive familjare.

Po ashtu vend të konsiderueshëm merr edhe GLN (plin) me 49.19%.

Tabela 9. Konsumi i energjisë nga ekonomitë familjare (pjesëmarrja në numrin e përgjithshëm të amvisërive,%)

Lloji i energjisë	Në zonat Urbane	Në zonat Rurale	Total
Energjia Elektrike	100,00	99,70	99,80
Nxemje për ngrohjen e hapësirës	11,68	0,00	3,92
Benzin	7,17	6,13	6,48
Dizel	1,70	1,76	1,74
Drunjë	89,58	94,99	93,17
GLN	49,67	48,95	49,19
Thëngjill	3,92	2,69	3,10
Panele Solare	0,52	0,93	0,79

Të dhënat e Ekonomive familjare për nivelin e konsumit të lëndëve djegëse bazuar në rezultatet e anketës janë paraqitur në Tabelën 10. Këto të dhëna mbulojnë konsumin në të gjitha Ekonomitë familjare, duke përjashtuar energjinë e përdorur për aktivitetet e biznesit vendas.

Në Tabelën 10 janë prezantuar të dhënat e shfrytëzimit total të energjisë nga ekonomitë familjare.



Tabela 10. Konsumi i energjisë nga ekonomitë familjare (njësitë natyrore)

Lloji i energjisë	Njësia	Në zonat Urbane	Në zonat Rurale	Total
Energji Elektrike	GWh	939,06	1269,53	2208,59
Nxemje	GWh	80,48	0,00	80,48
Benzin	Ton	525,97	337,22	863,19
Drunjë në mijë	m <sup>3</sup>	853,94	1.554,57	2.408,51
Dizel	Litër	1.267,03	789,75	2.056,78
GLN	Ton	2.990,71	4.158,53	7.149,24
Thëngjill	Ton	29.342,02	17.434,53	46.776,56
Panele Solare	m <sup>2</sup>	3233,08	2130,75	5363,83

Konsumi total i energjisë nga ekonomitë familjare u llogarit duke përdorur vlerat kalorifike mesatare të lëndëve djegëse. Anketa tregoi se sasia më e madhe e energjisë që përdoret nga ekonomitë familjare bazohet në lëndët djegëse drurore.

Tabela 11. Konsumi i energjisë nga ekonomitë familjare shprehur në Terraxhul (TJ)

Lloji i energjisë	Në zonat Urbane	Në zonat Rurale	Total
Energji Elektrike	3380.24	4569.82	7950.06
Nxemje	289.69	0.00	289.69
Benzin	23.14	14.84	37.98
Drunjë	4,764.07	8,672.82	13,436.89
Dizel	53.60	33.41	87.01
GLN	136.25	189.45	325.71
Thëngjill	797.80	474.04	1,271.85
Panele Solare	58.88	38.81	97.69

Për analizimin e sasisë së konsumit të çdo burimi të energjisë nga një ekonomi familjare, shuma totale u nda nga numri i ekonomive familjare që konsumonin këtë burim të veçantë.

Tabela 12. Konsumi mesatar i energjisë për një ekonomi familjare sipas llojeve të energjisë

Lloji i energjisë	Njësia	Në zonat Urbane	Në zonat Rurale	Total
Energji Elektrike	kWh	8022,61	5870,98	6626,64
Nxemje	kWh	687,56	0,00	241,47
Benzin	Liter	5,78	1,98	3,31
Drunjë	m <sup>3</sup>	7,30	7,19	7,23
Dizel	Liter	12,99	4,38	7,41
GLN	Liter	45,99	34,62	38,61
Thëngjill	Ton	0,25	0,08	0,14
Panele Solare	kWh	23,36	8,33	13,61

#### 4.2. Ngrohja e hapësirës

Në Kosovë, sistemet e ngrohjes qendrore janë të përhapura për furnizimin e banesave me nxehtësi, veçanërisht në zonat urbane si Prishtina dhe Gjakova. Rreth 70.35% e banesave përdorin drurin<sup>2</sup> si një burim ngrohjeje, 18.18% e përdorin vetëm energjinë elektrike si burim për ngrohje, 7.10% e përdorin thëngjillin si burim të energjisë, 4.02% konsumojnë nxehtësi nga sistemi qendror apo edhe lokal për ngrohjen e hapësirave dhe 0.35% përdorin alternativa tjera.

Tabela 13. Burimet e nxehtësisë për ngrohjen e hapësirës (%)

Burimet e nxehtësisë	%
Drunjë	70,35
Energji elektrike	18,18
Thëngjill	7,10
Nxemje	4,02
Tjera	0,35

<sup>2</sup> Tek konsumi i drurit janë të përfshira edhe mbeturinat e drurit si dhe paleta e briketi

## 5 Pajisjet elektrike në ekonomitë familjare

Konsumi i energjisë elektrike në Kosovë është rritur në vitet e fundit. Studimet në disa vende të BE-së kanë treguar se rritja e konsumit të energjisë elektrike për ekonomitë familjare nuk do të thotë se ato nuk e kursejnë energjinë elektrike. Përdorimi i energjisë elektrike po rritet kryesisht për shkak të numrit në rritje të pajisjeve në pronësi të ekonomive familjare. Rezultatet e kësaj anketë mundësojnë që të tregohet gjendja aktuale e konsumit të energjisë elektrike për gjitha pajisjet dhe në veçanti pajisjeve kryesore.

Ekonomitë familjare përdorin një numër të madh të pajisjeve elektrike, shumica e tyre marrin pjesë në konsumin total të energjisë elektrike.

Tabela 14. Përdorimi i pajisjeve elektrike më të përhapura

Lloji i pajisjes	Në 100 ekonomi familjare
Televizor	114,11
Lavatriqe	103,75
Thithëse elektrike	103,64
Tharëse për flokë	89,99
Hekur për hekurosje	82,52
Frigorifer	81,59
Shporet elektrik	80,45
Frizë	69,06
Kompjuter	45,10
Mikser	40,65
Pompa	37,63
Mikrovalë	22,59
Nxemse elektrike	17,84
Studio	9,22
Bocë	4,65
Tupan	4,02
Ftohëse	3,51
Kondicioner	1,63
Makinë elektrike për prerjen e barit	1,06

Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

621:64

Konsumi i energjisë në ekonomitë familjare 2015/  
publikimin e përgatitën Ilir T.Berisha. – Prishtinë : Agjencia e  
Statistikave të Kosovës, 2018. – 15 f. : ilustr. ; 28 cm.

1.Berisha, IlirT.

**ISBN 978-9951-22-456-7**

# Agjencia e statistikave të Kosovës

## *përshkrim i shkurtër*

**Agjencia e statistikave të Kosovës** është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Agjencia e statistikave të Kosovës** ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse;** (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Ne kuadër të Agjencionit veprojn edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 143 punëtorë, prej tyre, 98 (68,5%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 45 (31,5%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 61,7% me shkollim universitar, 15,4 me shkollim të lartë, ndërsa 17,5% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisve raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomive Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë . Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

**Misioni i Agjencionit;** të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë , bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129  
Kryeshafi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** [infoask@rks-qov.net](mailto:infoask@rks-qov.net)
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-qov.net>

ISBN 978-9951-22-456-7



9 789951 224567